

# **RIPARIM URA E VANES**

**(Perforcim shpatulla dhe ndertim pileb/a e re)**

Delvine 2023

## **PERMBAJTJA E RAPORTIT**

**1. HYRJE**

**2. QELLIMI**

**3. GJENDJA EKZISTUESE**

**4. PROJEKT ZBATIMI**

**PILAT**

**RIPARIMI I BALLIT EKZISTUES DHE NDERTIM SPERONI B/A**

**RIPARIMI I PJESHEM I KASKADES**

## **1.Hyrje**

Projektuesi per Objektivin : Riparim ura Vane, ne Bashkine Delvine, ka ndjekur hapat e nevojshem te studimit e investigimit per te proceduar ne fazen e projekt zbatimit, analizimit dhe zgjidhjes paraprake te kesaj vepre. Ne kete faze, eshte paraqitur projekti i piles se ures e cila do te ndertohet e re, si dhe riparimi i ballit ne hyrje te saj. Bashkelidhur raportit jane Detajet Grafiko-teknike, preventivi dhe te gjitha dokumentat e tjera te nevojshme per zbatimin e Projektit. Zgjidhja e riparimit i referohet kushteve topografike, kerkeses se Autoritetit Kontraktor dhe kushteve te trafikut ne kete aks.

## **2.Qellimi**



Qellimi i ketij projekti eshte hartimi i dokumentacionit te nevojshem (vizatime, volume, llogaritje, specifikime teknike etj.) per zbatimin e objektit brenda parametrave teknik te kerkuara nga standardet. Prioritet ne hartimin e ketij projekti ka edhe faktori ekonomik mbi te cilet u bazua menyra e nderhyrjes dhe hartimi i projekt zbatimit.

## **3.Gjendja ekzistuese**


Objekti ndodhet ne Rrugen per ne fshatin Vane,bashkia Delvine,100m nga rruga nacionale Sarande-Delvine, kjo ure e ndertuar mbi lumin Kalase esht nyja e vetme qe lidh fshatin vane me rrugen nacionale.Ne vitin 2022 si pasoje e reshjeve te shumta dhe me intesitet pesoje demtime ne ballin e saj si dhe u rrezua pila e ndermjeteme qe mbante mbistrukturen e cila ishte me konstruksion metalik. Me nderhyrjen e Forcave Xhenjere u be e mundur ndertimi i mbistrukture me konstruksion metalik(Bel),e cila eshte funksionale dhe sot. Aksi i ures ne projekt eshte perpendikular me rrjedhjen e lumit. Gjeresia e shtratit eshte e konsiderueshme, keshtu qe hapësira e drites e ures prej afro 15m secila i referohet shtratit te lumit, i cili ne kohe reshjesh sjell prurje te medha. Ura eshte ne lartesine e lire nga shtrati i lumit ( nga kuota e sistemuar) aferisht 4.60m. Gjendja ekzistuese e ures (objektit ne studim) dhe rrugeve lidhese, sic do te shihet edhe nga fotot e meposhtme eshte ne gjendje shume te degraduar. Struktura e ures eshte urë Bel, me 1 hapesine drite ~30m, me pjesen kaluese me dysheme drase dhe ball b/a, e cila shërben si urë per kalim mjetesh te tonazhit te ulet. Gjate inspektimit ne terren u konstata qe dyshemeja e drurit ishte e konsumuar,

Ballet e ures jane me struktura betoni ose b/a. Gjendja e tyre le per te deshiruar sidomos balli ne jug te ures i cili ka gerryerje ne bazament dhe rrezikon akoma me shume te vazhdoje kjo gerryerje. Njera pile eshte e rrezuar kurse tjetra ka ceduar dhe eshte i pamundur riparimi i saj.


Situata aktuale do te ilustrohet e detajuar nga fotot e meposhteme.





Ura ka nje gjeresi kaluese 4.0 m, ndersa Pjesa kaluese e ures eshte me dysHEME derrase.



Mbistruktura nuk mbeshtetet ne pilen ekzistuese e cila eshte e ceduar ne bazament.





#### 4. PROJEKT ZBATIMI

Fig.1 Planimetria e Ures




Fig.2 Pamja gjatesore





Fig.2 Pamja terthore






#### 4.1 Pila b/a

Ura eshte e gjate gjithsej 30ml dhe mbistruktura mbeshtetet ne dy ballnat

Pila b/a eshte projektuar qe t'i sherbeje dhe prespektives dhe siguron rritjen e hapesires se drites deri ne 30 m. Jasteku eshte b/a i projektuar te perballoje ngarkesat perkatese per hapesiren deri ne 30ml.


Fig.3 Pila b/a



## 4.2 Speronat dhe perforcimi i ballit ne jug te ures

Duke qene se balli ka geryerje ne bazament eshte menduar qe te ndertohet nje perforcim b/a dhe te ndertohen speronat per mbrojtjen e ballit.

Fig.3 Perforcimi i ballit b/a dhe speronat



### **4.3 Materialet kryesore qe do te perdoren ne ndertim**

Materialet teknike që do të përdoren për betonin, hekurin e ndërtimit, materiale të tjera të sistemeve të instaluar në urë do të respektojnë standartet e pranuar dhe me specifikimet teknike të cilat do të aprovohen nga ana e Bashkisë Delvine gjatë fazave të miratimit të projektit. Markat e betonit dhe klasa e hekurit janë përcaktuar të detajuara gjatë kësaj faze nga konstruktori bazuar në llogaritjet strukturore të tij.

### **4.4 Kërkesa dhe të dhëna projektuese**

#### **4.4.1 Kushtet Mjedisore**

Gjatë projektimit të veprës janë pasur parasysh respektimi i parametrave mjedisore për sa i përket elementëve të urës dhe ekspozimit të tyre nga agresiviteti të faktorëve të jashtëm si korrozioni. Kushtet mjedisore do të klasifikohen sipas tabelës 4.1 të EN-1992-1-1.

Elementët e ndërtimit të veprave të artit do të klasifikohen në lidhje me vendin ku ndërtohen, kjo e pasqyruar në vetitë dhe rezistencat e betonit, shtresat mbrojtëse etj.

#### **4.4.2 Jetëgjatësia Projektuese**

Jetëgjatësia projektuese do të përcaktohet duke u bazuar në Standartet Shqiptare të Projektimit dhe Zbatimit të Urave por edhe në baze të Eurokodeve. Gjithashtu do të referohet dhe EN 1990 siç përmendet më poshtë: “periudha gjatë së cilës supozohet se një strukturë, ose pjesë të saj, përdoren për qëllimin e planifikuar, me mirëmbajtjen të parashikuar, por pa pasur të domosdoshme riparime të mëdha”. Jetëgjatësia projektuese do të specifikohet, siç është e nevojshme, për përcaktimin e veprimeve të projektimit (p.sh reagimet sizmike), karakteristikat e materialeve, për zhvillimin e strategjive të mirëmbajtjes, etj.

#### **4.4.3 Vetite Fiziko Mekanike te Materialeve**

Materialet që do të përdoren për projektimin e strukturës (betoni dhe çeliku) do të specifikohen në mënyrë që të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në Standartet Kombëtare dhe Eurokodin 2 si dhe në Eurokodin 8.

EN 1998-1, 5.5.1(3)P kërkon që në elementët parësorë sizmikë të përdoret çelik armimi sipas EN 1992, Tabela C.1. EN 1998-1, 5.5.1(1)P kërkon që të mos përdoret klasë betoni më e ulët se C20/25 për klasë duktiliteti DCH.

Zgjedhja e materialeve do të kushtëzohet edhe nga respektimi i klasave orientuese të Tabela E.1N të EN 1992-1.

#### **4.4.4 Ngarkesat dhe veprimet ne strukturen e Ures**

Referuar peshes se struktures dhe automjeteve te dala nga llogaritja e trafikut, do te kihet parasysh qe gjate llogaritjeve dhe projektimit te strukturës së urës te merren në kosideratë të gjithë kategorite e veprimeve të jashtme dhe të brëndshme në urë:

Veprime të përhershme si: Pesha vetjake e elementeve strukture, pesha e elementeve sekondare dhe të jashtem, shtresa rrugore, veprimet jo të drejtperdrejta të shkaktuara në ndryshimet fiziko- kimike të elementevë gjatë zbatimit të punimeve.

Veprime të përkohshme sikurse janë ngarkesa nga mjetet, njerzit etj.

Veprimet e Erës dhe dëborës duke marë në konsideratë zonën ku ndërtohet ura.

Veprimet aksidenatale sikurse janë veprimet sizmike (Vlerësimi i shpejtimit maksimal referencë për truallin ku do të ndërtohet vepra do të bëhet duke marë në konsideratë publikimin e fundit të akademisë së shkencave të Republikës së Shqipërisë, me autore Sh. Aliaj, S. Kociu, B. Muco, E. Sulstarova “Sizmiciteti, Sizmoteknika, dhe vlerësimi i rrezikut Sizmik në Shqipëri” shpërthimet aksidentet etj.

Projekt zbatimi eshte realizuar i plote ne baze te standarteve te ndertimit ne fuqi. Ne kete faze, referuar edhe bashkebisedimit me specialist te Bashkise delvine, i eshte dhene perparesi Ures si investim i domosdoshem per komunitetin e fshatit vane.

**Pergatiti Ing. Aristotel Koci**

